

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN MARGEGAJ, TROPOJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Margegaj, Tropojë**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifatat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 93, datë 31.07.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 450/6, datë 31.7.2014, i ka rekomanduar z. Rexhe Byberi Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të hartohet plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, plani strategjik, të përcaktohen objektivat dhe hartohen plan veprimet afat shkurtra në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

Brenda muajt Gusht 2014

2. Të sigurohet zbatimi i procedurave lidhur me miratimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2014 dhe të analizohen të gjithë treguesit me material të veçantë dhe të miratohen në Këshillin e Komunës, në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, neni 11.

Dhjetor 2014

3. Të merren masa nga Komuna, në zbatim të buxhetit të vitit 2014, të listohen nevojat për blerje me vlera të vogëla, për të ruajtur kufirin maksimal të vlerës për një lloj artikulli dhe grup artikujsh të ngjashëm.

Gusht 2014

4. Nga Zyra e Financës të merren masa, për sistemimin e inventarit kontabël të llogarisë nr. 213, *“Rrugë rrjete e vepra ujore”*, për sa është rritur gabimisht vlera e ujësjellësit me 1 (një) miliard lekë mbi vlerën faktike të situacionit përfundimtarë.

Gusht 2014

5. Nga Zyra e Financës, të kryhen veprimet për zbritjen nga vlera e situacioneve përfundimtare të ndërtimeve (të palikuiduara) për 251,014 lekë në objektet:

I. *“Ndërtim këmbë urash fshati Dragobi e Klysyre”* me vlerë 167,963 lekë.

II. *“Ndërtim ekonomi peshku”* vlera 83,051 lekë, për sa është përfshirë gabimisht në prevntivat e punimeve vlera e projekt preventivit, supervizimit dhe kolaudit.

Gusht 2014

6. Nga Komuna të merren masa për të përcaktuar nivelin e gjobave dhe vendosjen e librit të shërbimit për Policinë e Komunës.

Gusht 2014

7. Nga Komuna të ngrihen grupe pune për verifikimin e bizneseve që ushtrojnë aktivitet në teritorin e Komunës dhe që nuk janë të regjistruar në QKR.

Menjëherë

8. Komuna Margegaj në bashkëpunim me Strukturat Shtetërore përkatëse të ndërmarrë veprimet e duhura ligjore për saktësimin e gjendjes juridike me ZVRPP, bërjen e korigjimeve, inventarizimin e gjendjes dhe pronësinë e pasurive përfshirë në listat e VKM nr. 327, datë 19.03.2008, “ Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Margegaj Qarku Kukës “ që i kanë kaluar në pronësi dhe përdorim, si dhe të verë nën administrim dhe efikasitet pasuritë, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr 8652, datë 31.7.2000 ”Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore.

Shtator

2014

9. Nga Komuna të merren masa për hartimin e rregullores për funksionimin e Komunës, ku të përcaktohen detyrat funksionale për çdo zyrë dhe post pune.

Shtator 2014

10. Nga Komuna të merren masa për hartimin e regjistrit themelor të subjekteve fizik, juridik dhe abonentëve familjarë, tarifën e biznesit, tokës bujqësore, taksën e ndërtesë në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime.

Gusht 2014

11. Nga Komuna të merren masa dhe të kërkohet zyrtarisht Prokurorisë së rrethit Tropojë shpjegime, për grabitjen e shumës 1,849,683 lekë, shumë e cila është e regjistruar në kontabilitet në llogarinë nr. 468 ”Debitorë në persona”, e trashëguar që nga viti 1999, dhe nuk ka dokumentacion shpjegues.

Tetor 2014

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

- Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjyqimit e ato përmbarimor, me qëllim shpërblimin e dëmit me vlerën: 4,393,043 lekë (pa TVSH), nga subjekti “I.C.P.-04”shpk, përfaqësuar nga ing. Dragush Halilaj, i licencuar (licenca me nr. MK0464/1), në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, për marrjen në dorëzim të punimeve të pa kryera krahasimisht me situacionin përfundimtar në ndërtimin e objektit “Rruga Dragobi – Motinë”.

Brenda muajt Tetor 2014

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”

1. E.M., me detyrë Zv/kryetar i Komunës njëkohësisht i ngarkuar edhe me menaxhimin e tokave bujqësore pyje dhe kullota, për:

- Moszbatim të plotë Ligji nr.9385, datë 04.5.2005, “ Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, neni 23 dhe VKM nr. 22. datë 09.01.2008 “ Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal, pikat 5,6,8,14,15,16,20.

- Të VKM nr.253,datë 6.3.2013” Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, nuk është plotësuar regjistri me kërkesat e paraqitura nga përdoruesit faktik të tokës bujqësore sipas pikës 2, të VKM.

- Nuk është plotësuar regjistri i pronave sipas udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, kreu III-të “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”,pika 26.

-Nga komuna Margegaj nuk janë pasqyruar ndryshimet për pasuritë e paluajtshme të transferuara paraprakisht dhe nuk është azhurnuar regjistri i pronave (troje dhe ndërtesa).

-Nga Komuna nuk është bërë asnjë regjistrim në ZVRPP të rrethit Tropojë,nga pronat pyje e kullota të kaluara përfundimisht në pronësi të Komunës Margegaj, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.327,datë 19.03.2008 “ Për miratimin përfundimtarë të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota,komunës Margegaj”, i janë transferuar në pronësi me numër fletesh 4(katër) dhe numër pronash 113(Njëqindetrembëdhjetë) si dhe lidhjes nr.1, që i bashkëngjitej këtij vendimi prona me një sipërfaqe 2263.45 ha .

2. Z.I., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës.

-Nuk është respektuar numri rendorë me rend rritës i prerjes së dokumentave të magazinës (fletë hyrje dhe fletë dalje). U konstatuan raste të prerjes së dokumentave në momentin e likuidimeve dhe jo në çastin kur tërhiqet malli dhe për pasojë u konstatuan raste të dokumentimit në hyrje dhe dalje të mallrave në vitin pasardhës. Këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.11.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III-të , për veprimet që kryejnë strukturat e nënpunësit zbatues,pika 53.

-Për sa është tejkaluar kufiri i blerjeve me vlera të vogëla për një artikull, për vitin 2011 është blerë çimento me vlerë 2,624,800 lekë, rërë 1,384,800 lekë, gurë 1,792,800 lekë. Për vitin 2012 në artikullin çimento 656,000 lekë, rërë 1,626,000 lekë, në kundërshtim me udhëzimin e KM nr. 2,datë 18.2.2008,” Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 2 e 4,i ndryshuar.

Shënim:

Nuk mund të rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet administrative të konstatuara pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla pasi 3 personat e mëposhtëm nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen dhe zbatimin e tyre.

1.Për I.ZH., anëtarë i KVO, aktualisht pensionist (larguar).

2.Për I.I., anëtar i KVO,i larguar nga puna.

3.Për B.B., anëtar i KVO, i larguar nga puna.

Nga Komuna Margegaj, Tropojë me shkresë protokolluar në KLSH me nr. 450/7 datë 25.8.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **ku rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Pal Daci, Luan Kuka dhe Abdulla Duka, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHITETIT